

## **AKT THEMELIMI**

Sot ne dt. 12 Korrik 2024 me cilesine e "Ortakut te Vetem Themelues",

**STEFANO VLLAHULI**, i datelindjes 15/02/1992, i lindur dhe banues ne Sarande, lagjia Nr.1, Rruga Gjergj Araniti , Nr. 84, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet Leternjoftimit me nr. J20215112G ,leshuar nga MB me date 03/03/2020,i cili me vullnet të lire të plote e të sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne ligjin "Per QKB", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin **Digital City** shpk.

### **KREU I**

#### **Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja,Objekti**

##### **Neni 1**

##### **Emertimi**

Emertimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **Digital City** shpk. Shoqëria do të nenshtrohet legjisllacionit Shqiptar.Shoqëria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues.

##### **Neni 2**

##### **Forma Juridike**

Shoqëria **Digital City** shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqëri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqëria").

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria **Digital City** shpk, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaku i vetem që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

##### **Neni 3**

##### **Selia**

#### **Shoqëria e ka seline ne adresen:**

#### **Sarande, Lagjja Nr.1, Rruga Gjergj Araniti , Godina nr.84**

Shoqëria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakut te vetem.

##### **Neni 4**

#### **Objekti i veprimtarise**

**Qender tregtare elektronike dhe poste shperndarje ushqimesh.**

##### **Neni 5**

##### **Kohezgjatja**

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKR.

### **KREU II**

#### **KAPITALI**

##### **Neni 6**

##### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte **1.500.000** lekë.

Kapitali i shoqerise eshte **1.500.000** leke i perbere nga 1 kuote dhe zoterohet nga ortaku i vetem i shoqerise. Z. **STEFANO VLLAHULI**

Vlera totale e Kapitalit te Regjistruar eshte **1.500.000 Leke**

Vlera Totale e Kapitalit te Paguar **1.500.000 Leke**, eshte paguar nga ortaku themelues. Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaku i vetem themelues pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise;

#### Neni 7

#### Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakut te vetem.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

### KREU II

### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

#### Neni 8

#### Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakut te vetem themelues eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise. Asambleja e Ortakut te vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Ortakut te vetem brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

#### Neni 9

#### Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga nje administrator i vetem.

Administrator i shoqerise eshte emeruar **STEFANO VLLAHULI**, i datelindjes 15/02/1992, i lindur dhe banues ne Sarande, lagjia Nr.1, Rruga Gjergj Araniti , Nr. 84, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet Leternjoftimit me nr. J20215112G ,leshuar nga MB me date 03/03/2020.

Emerimi i administratorit eshte me nje afat pese vjecar me te drejte riemerimi, i cili ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet e themelimit te shoqerise te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se ortakut te vetem te shoqerise.

#### Neni 10

#### Kompetencat

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht Asamblese se ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e ketij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratori ose ortakut që nuk janë persona juridikë nuk u lejohe të kontraktojnë në

çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12

Shperndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne cdo kohe dhe per çfaredo shkak, edhe para plotesimit të afatit per të cilin është krijuar siç mund të jone

- Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarisë se saj.
- Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji "Per Falimentimin"
- Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Ortakut te vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqëri ne likuidim e siper ".

Neni 13

Baza Ligjore

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 date 14.04.2008"Per tregtaret dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil , Ligji per QKR, dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqërisë.

Neni 14

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne tre ekzemplare me permbajtje dhe vlere te njejtë juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku i vetem themelues i shoqërisë tregtare **Digital City** shpk, nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.

**ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË**

**STEFANO VLLAHULI**

